



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

MINISTRI

Nr. 4806/1 Prot.

Tiranë, më 22.06. 2026

URDHËR

Nr. 251, datë 22.06. 2026

PËR

**NGRITJEN E NJËSISË PËRGJEGJËSE PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E
SINJALIZUESVE NË MINISTRINË E ARSIMIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 96/2025, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të vendimit nr. 395, datë 28.5.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për marrëdhëniet e punës, strukturën dhe kriteret e përzgjedhjes së punonjësve të njësive përgjegjëse të sinjalizimit në autoritetet publike” dhe të urdhrit nr.186, datë 15.10.2025, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e njësive përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Ministrinë e Arsimit, me përbërje si më poshtë:
 - a. Znj. Silvana Gushali, Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm;
 - b. Z. Isa Neza, Specialist në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm.
 2. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve do të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe do të zbatojë të gjithë procedurat që parashikon legjislacioni në fuqi.
 3. Njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve do të mbajë në vijimësi kontaktet me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
 4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm dhe Njësia Përgjegjëse për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

MIRELA KUMBARO FURXHI

